



Prishtinë: 30.03.2011

Kodi i ZRRE-së: V_353_2011

Nr.i Referencës: ZRRE/DMK_V_517_02_11

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, Nenit 17 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
4. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
5. Vendimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_517_02_11**;
6. Apelimi i konsumatorit me datë 08.02.2011;

Në mbledhjen e mbajtur më 30 mars 2011 nxori këtë:

VENDIM

REFUZOHET pjesërisht apelimi i konsumatorit Sali Haradini (shifra e konsumatorit DPR – 44627) nga Fushë Kosova, si në arsyet e paraqitura të këtij vendimi.

Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK-së me datë 27.11.2008 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 10.11.2008 lidhur me kontestimin e ngarkesës së shfrytëzimit të paautorizuar.

- Me datë 29.04.2008 konsumatori ka bërë kërkesë zyrtare për ndërrimin e njehsorit elektrik nr. 3639929.
Provë: Aplikacioni për ndërrim njehsori datë 29.04.2008
- Me datë 29.04.2008 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për ndërrim njehsori me kërkesë të konsumatorit kanë larguar nga matja njehsorin elektrik nr. 3639929 dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik nr. 31977188.
Provë: Vërtetimi mbi ndërrimin e njehsorit nr. 004519 datë 29.04.2008
- Me datë 27.06.2008 punëtorët e qendrës së kalibrimit kanë bërë kontrollimin detal të njehsorit elektrik nr. 3639929, ku është konstatuar se njehsori elektrik vulat (bllombat) shtetërore i ka në rregull, nga ana e jashtme kapaku i epërm është i shpuar (ka vrimë) dhe pjesa kyçëse e djegur, përmes vrimës është penguar puna e disku, ka copa druri në brendi, si dhe disku i gërvishtur.
Provë: Procesverbali me nr. 6/27 i datës 27.06.2008
- Me datë 03.07.2008 punëtorët e autorizuar për shqyrtim njehsori kanë shqyrtuar njehsorin elektrik nr. 3639929 ku kanë konstatuar se nuk mund ti behet shqyrtimi i matjes për shkak se ka pjesën kyçëse të djegur.
Provë: Protokoll i mbi shqyrtimin e njehsorit elektrik nr. org. 02/4317 datë 03.07.2008



- Me datë 13.08.2008 zyrtarët e autorizuar të KEK-ut kanë dalë te konsumatori dhe kanë bërë regjistrimin e të dhënave teknike të pikës matëse.
Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 176024 i datës 13.08.2008
- Me datë 29.08.2008 KEK-u ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar me anë të faturës DPR08HP06653 në vlerë prej 2,151.70 €.
Provë: Fatura DPR08HP06653 e datës 29.08.2008
- Me datë 24.09.2008 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike.
Provë: Ankesa e konsumatorit në KEK
- Me datë 10.11.2008 Departamenti për Konsumator në KEK i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke thirrur në procesverbalin e kontrollës dhe të kalibrimit.
Provë: Përgjigja e KEK-ut e datës 10.11.2008
- Me datë 27.11.2008 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.
Provë: Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së
- Me datë 02.02.2011, DMK duke u bazuar në analizat e bëra lëndës së konsumatorit ka lëshuar vendimin nr. ZRRE/DMK_V_517_02_11 duke refuzuar ankesën e konsumatorit si të pabazë.

Bordi i ZRRE-së ka analizuar Vendimin e lëshuar nga DMK: ZRRE/DMK_V_517_02_11 dhe ka konstatuar se vendimi është në pajtim me Rregullat e ZRRE-së. Por, që duke pasur për bazë shpenzimet e energjisë elektrike si dhe mesataren e shpenzimeve të energjisë elektrike të konsumatorit konstatohet se konsumatori nuk ka ndryshim të shpenzimit të energjisë me njehsor të ri dhe me njehsor të vjetër andaj, konsumatori duhet të ngarkohet me rikthim të humbjeve bazuar në shpenzimin më të madh mujor me njehsor të ri për periudhën një vjeçare (05/2008 – 04/2009) në vlerë **870 kWh/muaj**. Bordi i ZRRE-së ka vendosur ta **refuzojë pjesërisht** konsumatorin për arsyet e paraqitura në vendimin e DMK të ZRRE-së.

Bordi i ZRRE-së obligon KEK-un që:

1. Shkarkon konsumatorin nga fatura e rikthimit të humbjeve DPR08HP06653 në vlerë prej 2,151.70 €.
2. Ngarkoj konsumatorin me faturë të rikthimit të humbjeve për periudhën një vjeçare (05/2007 – 04/2008) bazuar në shpenzimin mujor **870kWh/muaj**.
3. Pas rikalkulimit të bërë ngarkesës së shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike (rikthim i humbjeve), sipas pikave të cekura më lart, duhet të njoftoj ZRRE-në për këtë rikalkulim



Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente, brenda **katërbëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimit të këtij Vendimi.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar